

RAPORTI I VITIT 2017 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova është demokraci parlamentare. Kushtetuta dhe ligjet parashikojnë një parlament të zgjedhur njëdhomësh, Kuvendin, i cili më pas e zgjedh një kryetar. Kuvendi duhet ta miratojë kryeministrin të cilin e zgjedh kryetari. Vendi i mbajti zgjedhjet parlamentare më 11 qershor, të cilat vëzhguesit ndërkombëtarë i konsideruan të lira e të drejta. Kuvendi e zgjodhi Hashim Thaçin për President në shkurt të vitit 2016. Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX), që monitoron policinë dhe sektorin e drejtësisë, vazhdoi të kryente disa funksione ekzekutive, me misionin e tij të vazhduar deri nga mesi i vitit 2018. Dialogu për normalizimin e marrëdhënies mes Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga BE-ja, vazhdoi në mënyrë të çrregullt, pasi të dy presidentët u pajtuan ta zbatojnë marrëveshjen e tyre të vitit 2015 për integrimin e strukturave gjyqësore të Kosovës veriore në strukturat nacionale që nga 17 tetori.

Autoritetet civile mbajtën kontroll efikas të forcave të sigurisë.

Sulmet ndaj gazetarëve; dhuna ndaj personave të zhvendosur; korrupsioni endemik në qeveri; mungesa e pavarësisë gjyqësore, përfshirë dështimet në proces të drejtë dhe zbatimin selektiv të vendimeve; dhe dhuna ndaj anëtarëve të pakicave etnike dhe anëtarëve të komunitetit të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transjinorëve dhe interseksualëve (LHBTI) përbënin shqetësimet më të mëdha të të drejtave të njeriut.

Qeveria ndërmori masa për t'i ndjekur penalisht dhe dënuar zyrtarët që kryen abuzime në shërbime të sigurisë apo gjetiu në Qeveri. Shumë veta në opozitë, shoqëri civile dhe media mendonin që zyrtarët e lartë përfshiheshin në korrupsion pa u ndëshkuar.

Seksioni 1. Respektimi i integritetit të personit, përfshirë lirinë nga:

a. Privimi arbitrar i jetës dhe vrasjet e paligjshme apo të motivuara politike

Nuk pati raportime që Qeveria apo agjentët e saj kryen vrasje arbitrare apo të paligjshme.

Prokurorë të EULEX-it dhe vendorë vazhduan ndjekjen penale të krimeve të luftës që buronin nga konflikti i vitit 1998-99. Që nga gushti, prokurorët e EULEX-it ishin duke punuar në 37 raste të krimeve të luftës. Sipas marrëveshjes në fuqi, EULEX-it mund t'i caktohen raste të reja vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, me miratim të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Që nga gushti, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ishte duke i hetuar përafërsisht 104 raste të krimeve të luftës, prej të cilave 44 ishin pezulluar pasi nuk dihej vendndodhja e autorëve të supozuar.

Në korrik, policia e EULEX-it dhe e Kosovës arrestuan katër persona në lidhje me vrasjen e vitit 2004 të një polici të UNMIK-ut dhe të një polici të Kosovës dhe plagosjen e dy policëve të tjerë. Prokurorët kërkuan ekstradimin e të dyshuarit të pestë nga Gjermania. Duke cituar burime të policisë, mediat i identifikuan dy të dyshuar si anëtarë të një grupi

KOSOVA

të madh të krimit të organizuar të përfshirë në vrasjet politike të pasluftës, sulme terroriste dhe zhvatje.

Në korrik, një panel me shumicë nga EULEX-i në Gjykatën Supreme e prapësoi dënimin e vitit 2016 të Sami Lushtakut, kryetar i Skenderajt, për akuza për krime lufte në të ashtuquajturin rasti Drenica I. Nga fundi i vitit 2016, Gjykata e Apelit e ndryshoi dënimin fillestar të Lushtakut për vrasje dhe e dënoi për përgjegjësi komanduese për krime lufte të kryera në qendrën e paraburgimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Paneli i Gjykatës Supreme mbështeti dënimin prej pesë vjetësh për të pandehurin Jahir Demaku, ish-drejtor i Inteligjencës dhe Sigurisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Më 18 gusht, një panel me shumicë nga EULEX-i në Gjykatën Supreme mbështeti dënimet për 10 të pandehurit në rastin për krime lufte Drenica II. Në gusht rifilloi gjykimi për serbin e Kosovës Oliver Ivanoviq, i dënuar më 2016 me nëntë vjet burg për krime lufte kundër shqiptarëve të kryera në vitin 1999. Ivanoviq u lirua me dorëzani në pritje të rigjykitimit në prill.

Prokuroria e Specializuar e Kosovës (PSK), me seli në Hagë, vazhdoi t'i hetonte krimet e kryera gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. PSK dhe paraardhësi i saj, Task Forca e BE-së për Hetime Speciale, u themeluan pas publikimit në vitin 2011 të Raportit të Këshillit të Evropës, Trajtimi jonjerëzor i njerëzve dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë, në të cilin pohoheshin krimet e kryera nga prijës individualë të UÇK-së. Marrëveshja e vitit 2016, e cila ofronte bazë ligjore që Dhomat e Specializuara të Kosovës t'i zhvillonin procedurat në Holandë, hyri në fuqi më 1 janar. Më 22 dhjetor, një grup i parlamentarëve nga koalicioni qeverisës u përpoq ta shfuqizonte ligjin me të cilin autorizoheshin PSK-ja dhe Dhomat e Specializuara. Disa parlamentarë raportuan se vepruan kështu sipas udhëzimeve nga liderët politikë. Kjo nismë u pengua për shkak të presionit nga liderët opozitarë dhe bashkësia ndërkombëtare, por mbështetësit vazhduan të nxitnin për shfuqizim të tij deri në fund të vitit. PSK nuk kishte ngritur asnjë aktakuzë deri në fund të vitit.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje nga apo në emër të autoriteteve qeveritare.

Deri në gusht, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) kishte të regjistruar 1.658 persona që u zhdukën gjatë konfliktit të vitit 1998-99 dhe dhuna politike që pasoi. Ndonëse KNKK nuk i dallonte personat e zhdukur sipas prejardhjes etnike për shkak të kufizimeve për konfidencialitet, vëzhguesit vlerësuan që rreth 70 për qind e tyre ishin shqiptarë dhe 30 për qind ishin serbë, romë, ashkalinj, egjiptianë, boshnjakë dhe malazezë.

c. Torturimi dhe trajtimet apo ndëshkimet e tjera të egra, çnjerëzore apo poshtëruese

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë praktika të tilla dhe nuk pati raportime që zyrtarët qeveritarë i përdorën ato.

KOSOVA

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), një organ i pavarur në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ishte përgjegjës për shqyrtimin e ankesave për sjellje të policëve. Deri në korrik, IPK shqyrtoi 678 ankesa të qytetarëve për sjellje të policëve. IPK i cilësoi 404 sosh si shkelje disiplinore dhe ia përcolli Njësisë për Standarde Profesionale të PK-së; IPK i cilësoi 264 ankesa si raste penale. Deri në korrik, 124 zyrtarë policorë ishin nën hetime dhe 135 raste nga viti 2016 mbetën nën hetime. Pretendimet për përdorim të tepërt të dhunës nga ana e policisë me rastin e shpërndarjes së një demonstrate në vitin 2015 nuk rezultuan në kallëzime penale, ndonëse prokurorët vazhduan t'i shqyrtojnë informatat e ofruara nga IPK-ja.

Më 13 maj, persona të panjohur rrahën ish-kryeredaktoren e Zërit dhe avokaten e njohur për të drejta të njeriut, Arbana Xharra. Më 10 prill, Xharra i tha policisë se persona të panjohur kishin vizatuar kryqe me ngjyrë në derën e hyrjes së saj. Hetimi ishte në vazhdim e sipër. Xharra u tha mediave se radikalë fetarë dhe aktivistë të partive opozitare e kishin sulmuar atë në media sociale gjatë tërë vitit.

Më 22 qershor, një panel me shumicë nga EULEX-i në Gjykatën e Apelit e ndryshoi pjesërisht një aktgjykim të vitit 2016 të lëshuar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës kundër ish-komandantit të UÇK-së, Xhemshit Krasniqi, për torturim të civilëve në vitin 1999.

Më 28 gusht, dy persona të panjohur sulmuan Vitore Stavilecin, bashkëshorten e ministrit për Zhvillim Ekonomik, Blerand Stavileci, duke i shkaktuar lëndime të rënda. Sulmi ndodhi pak kohë pasi ministri Stavileci publikisht e kritikoi qeverinë komunale të Prishtinës si jokompetente dhe të korruptuar, që i shtyri OJQ-të dhe vëzhguesit e tjerë të dyshonin për motive politike.

Kushtet në burgje dhe qendra ndalimit

Kushtet në burgje dhe qendra të ndalimit i plotësonin disa standarde ndërkombëtare, por pati probleme të mëdha në disa burgje, posaçërisht mungesa e programeve rehabilituese, dhuna ndërmjet të burgosurve, korrupsioni, ekspozimi ndaj pikëpamjeve radikale fetare apo politike dhe kujdesi mjekësor nën standarde.

Ish-drejtori i Qendrës së Ndalimit në Prishtinë, Emrush Thaçi, i akuzuar në vitin 2016 se i kishte ndihmuar kriminelit të luftës Sami Lushtaku t'i shmangej gjyqimit, ende priste të gjykohej.

Kushtet fizike: Kushtet fizike mbetën nën standard në disa reparte të Burgut të Dubravës, që ishin të stërngarkuara në çerekun e parë të vitit.

Gjatë këtij viti, Qendra e Kosovës për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRVT) pranoi ankesa nga të burgosurit për sjellje të pavend, ngacmim verbal, dhunë mes të burgosurve dhe, në disa raste, keqtrajtim fizik nga ana e zyrtarëve korrektues, kryesisht në Burgun e Dubravës dhe në Qendrën e Ndalimit në Lipjan.

Më 19 shkurt, tre zyrtarë korrektues e sulmuan një të paraburgosur në Qendrën e Ndalimit në Lipjan. Këta zyrtarë u qortuan, por nuk u larguan nga puna.

KOSOVA

Më 26 shkurt, dy të burgosura u përfshin në një përlëshje në Qendrën e Ndalimit në Lipjan, që përfundoi me lëndime. QKRVT raportoi se përlëshja ndodhi në praninë e zyrtarëve korrektues, të cilët nuk ndërhyjnë.

Mediat nacionale raportuan se të burgosurit e dhunuan një të burgosur në Qendrën e Ndalimit në Lipjan më 15 maj. Raportohet që viktimë mori trajtim mjekësor dhe psikiatrik, dhe zyrtarët e burgut e transferuan njërin prej autorëve të këtij akti në një qendër tjetër të ndalimit. Rasti ishte në hetim e sipër.

Deri në gusht, QKRVT kishte pranuar 150 ankesa nga të burgosurit që ishin abuzuar verbalisht ose fizikisht nga stafi korrektues në Burgun e Dubravës dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë.

Për shkak të korrupsionit apo ndërhyrjes politike, autoritetet nuk ushtronin gjithmonë kontroll ndaj objekteve apo të burgosurve. Sipas QKRVT-së, të burgosurit ankoreshin se zyrtarët në Burgun e Dubravës dhe të Smerkonics në mënyrë të paligjshme jepnin leje dhe kohë shtesë në oborr në sajë të nepotizmit apo ryshfetit. QKRVT raportoi se telefonat mobilë dhe drogat e paligjshme rregullisht kontrabandoheshin në objekte korrektuese; llogaritej se rreth 30 për qind e të dënuarve ishin të varur nga droga. Nuk pati programe për trajtim nga droga.

QKRVT dokumentoi vonesa dhe gabime në ofrimin e kujdesit mjekësor për të burgosur, si dhe mungesën e trajtimit të specializuar. Në shumë raste, këto kushte i detyruan të burgosurit t'i blinin barërat e nevojshme përmes burimeve private. QKRVT vërejti të meta në sistemin e kujdesit shëndetësor në Burgun e Dubravës dhe raportoi për numër të pamjaftueshëm të profesionistëve të shëndetit mendor.

Objektet dhe trajtimi për të burgosur me aftësi të kufizuara mbetën nën standarde. Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës ofronte trajtim të kufizuar dhe strehim për të paraburgosur me aftësi të kufizuara. Avokatët e personave me aftësi të kufizuara e fajësonin qeverinë që rregullisht i vendoste të paraburgosurit me aftësi të kufizuara mendore bashkë me të paraburgosurit e tjerë. Të paraburgosurit mbaheshin ndaras nga popullata e të burgosurve të dënuar.

Shërbimi Korrektues vazhdoi ta drejtonte një ekip ndërdisiplinor për t'i trajtuar vetëlëndimet dhe përpjekjet për vetëvrasje në objekte korrektuese, ndonëse avokatët e viktimave nuk ishin në dijeni për këto përmirësime. QKRVT vuri në pah se shërbimet psikosociale në Burgun e Dubravës dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë nuk ishin të mjaftueshme dhe të përshtatshme për nevojat e të burgosurve, përkundër disa përmirësimeve në Burgun e Sigurisë së Lartë. Nuk pati dispozita ligjore apo udhëzime administrative për trajtimin e të burgosurve me aftësi të kufizuara. Deri në gusht, QKRVT raportoi për 21 tentimvrasje dhe 100 vetëlëndime. Avokatët cituan transferimet e shpeshta dhe trajtimin e ashpër si faktorë kontribuues.

Më 16 gusht, sulmues të maskuar rrahën ushtruesin e detyrës së drejtorit të SHKK-së, Sokol Zogaj, me shufra metali në Prishtinë. Ministria e Drejtësisë lëshoi një deklaratë

KOSOVA

menjëherë pas sulmit duke u bërë thirrje autoriteteve që t'i gjenin autorët dhe t'i sillnin para drejtësisë.

Qeveria, me ndihmën e ekspertëve mjekoligjor ndërkombëtarë, vazhdoi hetimet lidhur me vdekjen e aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, për të cilin supozohej se bëri vetëvrasje në burg në vitin 2016. Në shtator, kryeprokurori i shtetit njoftoi që Ministria e Punëve të Brendshme e Austrisë i kishte përfunduar analizat e video xhirimit të kamerave të vëzhgimit në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në kohën e vdekjes së Deharit. Analizat nuk gjetën shenja të manipulimit të xhirimeve të kamerave të vëzhgimit. Prokuroria e Shtetit theksoi se do t'i analizonte edhe më tej provat lidhur me këtë rast.

Administrata: Autoritetet nuk zhvillonin gjithmonë hetime të duhura për keqtrajttime. QKRVT vuri në pah se mekanizmi i brendshëm për ankesa, i paraparë me ligj, nuk funksiononte, pasi të burgosurit shpesh nuk i lajmëronin abuzimet për shkak të mungesës së konfidencialitetit dhe frikës nga hakmarrja. QKRVT vëzhgoi disa raste në të cilat të burgosurit që kishin parashtruar ankesa ishin transferuar në burgje të tjera. Të burgosurit në disa reparte në Burgun e Dubravës dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë nuk kishin formularë për ankesa dhe udhëheqja e burgjeve dështoi t'i shqyrtonte shqetësimet e raportuara. Autoritetet e burgut nuk mund të intervenonin kur disa të paraburgosur i përdornin lidhjet në Ministrinë e Drejtësisë për t'u transferuar në lehtësira më komode, si në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë, madje edhe kur burgu ua ofronte shërbimet përkatëse mjekësore.

QKRVT gjithashtu vuri në pah se autoritetet nuk ofronin vendime me shkrim me të cilat arsyetohej izolimi në vetmi ose konfirmohej transferimi në ndonjë objekt tjetër. Sipas të burgosurve, vendimet e tilla zbatoheshin pa njoftim dhe sqarim. QKRVT vuri në pah se dështimi i autoriteteve për ta zbatuar ligjin për sanksione penale rezultoi në mungesë të procedurave të qarta për kërkesa për pushim dhe lirim me kusht

Edhe të burgosurit edhe punëtorët socialë konsideronin që Paneli për lirim me kusht dështonte në trajtimin me kohë të kërkesave për lirim të mëhershëm dhe për mungesë të qartësisë në arsyetimin e mohimeve të tij. Të burgosurit me të dhëna për sjellje të mirë e kritikuan mungesën e konsiderimit të rrethanave të tyre individuale nga paneli. SHKK-ja pranoi shtatë ankesa gjatë këtij viti.

Monitorimi i pavarur: Qeveria u lejoi vizita vëzhguesve të pavarur për të drejta të njeriut, por Instituti i Avokatit të Popullit ishte institucioni i vetëm që kishte qasje të vazhdueshme e të papenguar në objektet korrektuese. QKRVT dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut duhej të njoftonin 24 orë më parë për vizita të planifikuara.

Përmirësimet: Në maj, qeveria hapi një qendër korrektuese edukative për të mitur në Qendrën e Ndalimit në Lipjan. Menaxhmenti ekzistues i Qendrës së Ndalimit në Lipjan administronte me qendrën për të mitur, në kundërshtim të qartë të ndalimit ligjor kundër menaxherëve që drejtonin shumë institucione.

KOSOVA

Në mars, qeveria hapi një qendër të re ndalimi në Gjilan, me kapacitet për 300 të burgosur. Disa OJQ theksuan që kjo qendër nuk i përmbushte standardet themelore të sigurisë, duke theksuar sisteme të dobëta të mbikëqyrjes dhe dyer të cilësisë së dobët në qeli .

Qeveria gjithashtu e rinovoi Burgun e Dubravës gjatë këtij viti, pjesërisht duke i adresuar të metat në ndriçim dhe ventilim të dobët, kuzhinat dhe tualetet e vjetruara, mungesën e ujit të nxehtë, shtrojat joadekuate ose mungesën e tyre dhe vonesat e mëdha në meremetime.

d. Arrestimi ose ndalimi arbitrar

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe parashikojnë të drejtën e çdo personi për ta kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të tij/saj në gjykatë, dhe Qeveria, EULEX-i dhe Forca e Kosovës (KFOR), një forcë paqeruajtëse ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO, në përgjithësi i respektuan këto ndalesa.

ROLI I POLICISË DHE I APARATIT TË SIGURISË

Forcat vendëse të sigurisë përfshinin Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, një forcë për reagim civil me armatim të lehtë, që ofron reagime në raste fatkeqësie dhe ndihma humanitare, çmimin, kërkim dhe shpëtim, dhe kontrollim të materialeve të rrezikshme. Ligji parashikon që policia të funksionojë nën autoritetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Policia mbante sigurinë e brendshme, e ndihmuar nga EULEX-i si reagues i dytë për incidente të trazirave, dhe KFOR-i si reagues i tretë. Policia kufitare, pjesë e Policisë së Kosovës, ishte përgjegjëse për çështje të zbatimit të ligjit për menaxhimin e kufirit. FSK-ja menaxhohet nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Mandati i EULEX-it është t'i monitorojë, mentorojë dhe këshillojë institucionet vendëse të drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit. Ai gjithashtu ka disa përgjegjësi operative, ta mbështesë forcën policore gjatë bastisjeve dhe aksioneve ku kërkohet kontrolli i masës dhe i trazirave. Rrethanat nuk kërkuan që EULEX-i ta kryente këtë funksion gjatë këtij viti. Mandati i pavarur i EULEX-it për operacione policore është i kufizuar në raste të krimit të organizuar, korrupsionit të nivelit të lartë, krime të luftës, shpëlarje të parave, financim të terrorizmit dhe bashkëpunim policor ndërkombëtar. Ai gjithashtu u angazhua në mbrojtjen e dëshmitarëve dhe trajnim të policisë në këtë fushë. Roli ekzekutiv i EULEX-it shënoi rënie graduale, siç ishte paraparë në shkëmbimin e letrave mes qeverisë dhe BE-së në vitin 2014 dhe siç u vazhdua në vitin 2016.

KFOR-i ishte përgjegjës për të ofruar mjedis të qetë e të sigurt dhe për ta siguruar lirinë e lëvizjes në vend. Deri në maj, ky mision kishte 4.352 ushtarë nga 31 shtete.

Personeli i EULEX-it dhe i KFOR-it nuk i nënshtroheshin sistemit ligjor të vendit, por masave disiplinore të misionit dhe të vendeve të veta përkatëse.

Qeveria nganjëherë hetonte abuzimin dhe korrupsionin, ndonëse mekanizmat për ta bërë një gjë të tillë nuk ishin njëlloj efikas në tërë vendin. Forcat e sigurisë nuk siguronin pajtim me urdhra ligjor kur zyrtarët vendës dështonin t'i zbatonin ato. Shumë zyrtarë

KOSOVA

policorë janë arrestuar nën akuzat për korrupsion gjatë vitit dhe pandëshkueshmëria ishte problem.

Më 8 shtator, mediat raportuan se Polica e Kosovës ua ndërpreu kontratën 57 prej 59 policëve të arrestuar në vitin 2016 për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe ryshfet. Shumica prej tyre ishin pjesëtarë të njësisë së trafikut rrugor nga Mitrovica jugore e veriore, të cilët u zunë duke marrë ryshfet pasi IPK-ja kishte vendosur kamera vëzhgimi brenda veturave të tyre të patrullimit.

PROCEDURAT E ARRESTIMIT DHE TRAJTIMI I TË NDALUARVE

Sipas ligjit, përveç kur krimi është në zhvillim e sipër, policia mund të arrestojë të dyshuar vetëm me urdhra të bazuar në prova dhe të lëshuar nga një gjykatës ose prokuror. Brenda gjashtë orëve, prokurorët duhet t'ia lëshojnë personit të arrestuar një deklaratë me shkrim ku përshkruhen vepra e dyshuar dhe baza ligjore për akuzim. Autoritetet duhet t'i sjellin të arrestuarit para gjykatësit brenda 48 orëve dhe duhet t'u sigurojnë të ndaluarve qasje në avokatin të cilin e zgjedhin apo në avokatin e siguar nga shteti. Ekziston edhe sistemi i dorëzansisë, por rrallë përdoret nga gjykatat. Ato shpesh i lironin të ndaluarit pa dorëzani në pritje të gjykimit.

Të dyshuarit kanë të drejtë të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në të gjitha fazat e hetimit, përveç pyetjeve për identitetin e tyre. Të dyshuarit kanë të drejtë për ndihmë falas të përkthyesit dhe për trajtim mjekësor dhe psikiatrik. Policia nuk mund t'i mbajë të dyshuarit pa mundësi komunikimi.

Pas një aktvendimi fillestar, gjykata mund t'i mbajë individët në paraburgim deri në 30 ditë nga data e arrestimit, dhe mund ta vazhdojë paraburgimin deri në një vit. Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të procedurës gjyqësore, vetëm gjykatësi i rastit apo trupi gjykues mund ta caktojë apo ndërpresë paraburgimin. Ligji lejon që gjykatësi të urdhërojë arrestin shtëpiak, konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit dhe përdorimin e gjerë të dorëzansisë si alternativa ndaj paraburgimit.

Policia në përgjithësi i kryente arrestimet duke përdorur urdhërarreste, ndonëse në disa raste policët ishin të maskuar apo sekretë. Nuk pati raportime të konfirmuara që policia abuzoi rregullin 48-orësh, dhe prokurorët në përgjithësi ose u ofronin personave të arrestuar dokumente në të cilat cekeshin arsyet për ndalimin e tyre ose i lironin. Ndonëse zyrtarët në përgjithësi e respektuan kriterin për vendosje të shpejtë të rasteve, QKRVT raportoi se të ndaluarit nganjëherë përballeshin me vonesa kur avokatët përkohësisht nuk ishin në dispozicion.

OJQ-të raportuan se autoritetet nuk i lejonin gjithmonë personat e ndaluar të kontaktonin me avokatë me rastin e arrestimit dhe në disa raste u lejonin konsultime me avokat vetëm pasi hetuesit policorë kishin filluar marrjen formale në pyetje. Në disa raste, të ndaluarve iu lejua qasje në avokat vetëm pas marrjes formale në pyetje. Disa të ndaluar ankoreshin që, përkundër kërkesës për avokat, kontakti i tyre i parë me avokat ndodhte vetëm pas paraqitjes së tyre të parë në gjykatë.

KOSOVA

Arrestimi arbitrar: Më 13 shtator, policia bastisi zyrat e Kryqit të Kuq Serb në shtatë komuna në mbarë Kosovën. Policia tha se bastisjet ishin përgjigje ndaj asaj që ata e quajtën operacion i paligjshëm i regjistrimit, ndërsa zyrtarët e Kryqit të Kuq Serb thanë se grumbullimi i të dhënave të tyre ishte në mbështetje të ofrimit të ndihmës humanitare dhe monitorimit. Mediat dhe vëzhguesit ndërkombëtarë raportuan se në këto bastisje, policia u mbështet në “urdhra me gojë” nga prokurorët vendorë, në kundërshtim me ligjin. Policia përkohësisht ndaloi një numër të nëpunësve të Kryqit të Kuq Serb. Prokurorët dhe policia nuk qenë në gjendje të citonin në mënyrë specifike ndonjë dispozitë të kodit penal të cilën zyrat e Kryqit të Kuq Serb e kishin shkelur.

Paraburgimi: Ndalimet e gjata, para dhe gjatë procedurës gjyqësore, mbetën problem. Ligji u lejon gjykatësve ta ndalojnë të pandehurin në pritje të gjykimit nëse ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka të ngjarë t’i shkatërrojë, fshehë apo falsifikojë provat, të ndikojë në dëshmitarë, të ikën, ta përsërisë veprën penale, të kryejë ndonjë veprë tjetër penale, apo të mos paraqitet në procedura gjyqësore. Gjykatësit zakonisht e përdornin paraburgimin pa kërkuar justifikim të mbështetur në prova. Ndalimi i gjatë ndodhte gjithashtu për shkak të joefikasitetit dhe korrupsionit në gjyqësor.

Mundësia e të ndaluarve për ta kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit në gjykatë: Personat e arrestuar apo të ndaluar, pavarësisht veprës që kanë kryer, kanë të drejtë ta kundërshtojnë në gjykatë bazën ligjore apo natyrën arbitrare të ndalimit të tyre dhe të marrin lirim të menjëhershëm dhe kompensim nëse konstatohet që janë ndaluar në mënyrë të paligjshme.

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta parashikon një gjyqësor të pavarur, por gjyqësori nuk ofronte gjithmonë proces të drejtë. Sipas Komisionit Evropian, OJQ-ve dhe Zyrës së Avokatit të Popullit, administrimi i drejtësisë ishte i ngadalshëm dhe i mungonin mjetet për të siguruar llogaridhënie nga zyrtarët gjyqësorë. Strukturat gjyqësore i nënshtroheshin ndërhyrjes politike, me emërime të diskutueshme dhe mandate të paqarta. Efikasiteti në zgjidhjen e rasteve u përmirësuar gjatë vitit, por gjykatat ishin të ngarkuara me numër të madh të rasteve të pazgjidhura. Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, gjykatat vendosën në 170.000 raste dhe pranuan 130.000 raste të reja. Sipas Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 358.135 raste civile e penale administrative e komerciale pritnin të gjykoreshin deri në korrik. Përveç kësaj, 154.596 raste të kundërvajtjes pritnin të gjykoreshin.

Një mekanizëm për procedura disiplinore kundër gjykatësve dhe prokurorëve ishte në vend, por ishte joefikas. Autoritetet nganjëherë nuk i respektuan urdhrat e gjykatave, përfshirë urdhrat e Gjykatës Kushtetuese, posaçërisht për aktvendimet në favor të pakicave.

Përkundër një urdhri të Gjykatës Kushtetuese që konfirmonte pronësinë e Kishës Ortodokse Serbe për më tepër se 24 hektarë tokë afër Manastirit të Deçanit, autoritetet lokale në Deçan nuk e zbatuan vendimin. Kisha Ortodokse Serbe e referoi këtë çështje në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, por regjistrimi ende nuk është kryer. Asnjëri prej zyrtarëve të përfshirë në dështimin për ta zbatuar urdhrin e gjykatës nuk u sanksionua.

KOSOVA

Prokurorët dhe gjykatësit e EULEX-it funksionuan si anëtarë të sistemit gjyqësor të vendit. Shefja e PSRK-së, juridiksioni i të cilës përfshinte trafikimin e personave, krimet kundër njerëzimit, shpëlarjen e parave, krimet e luftës dhe terrorizmin, kishte një prokuror të EULEX-it si zëvendës të saj. Në pajtim me shkëmbimin e letrave mes qeverisë dhe BE-së, prokurorët e EULEX-it mund të veprojnë në mënyrë të pavarur apo bashkë me prokurorët vendorë në pajtim me ligjin në fuqi. Si rrjedhojë, EULEX-i mori disa raste të reja dhe procedoi rastet që ishin në vazhdim e sipër.

Më 24 tetor, Presidenti lëshoi një dekret me të cilin emëronte 40 gjykatës dhe 13 prokurorë serbë, siç ishin dakorduar sipas Marrëveshjes së Dialogut për gjyqësor. Gjykatat në Mitrovicën veriore, që më parë kishin funksionuar nën sistemin gjyqësor serb, u njohën si gjykata të Kosovës dhe filluan zbatimin e ligjeve të Kosovës. 8.000 raste të pazgjidhura civile e penale, nga të katër komunat me shumicë serbe, që ishin transferuar në Vushtrri në vitin 2016, u kthyen në Mitrovicën veriore për procedim të mëtejshëm.

PROCEDURAT E GJYKIMIT

Ligji parashikon gjykim të drejtë e të paanshëm dhe ndonëse pati të meta të mëdha në sistemin gjyqësor, ai në përgjithësi u respektua. Gjykimet janë publike dhe të pandehurit gëzojnë prezumimin e pafajësisë, të drejtën për t'u informuar me kohë dhe hollësisht për akuzat kundër tyre, të jenë të pranishëm në gjykimet e veta, të heshtin, të mos detyrohen të dëshmojnë apo ta pranojnë fajësinë, të përballen me dëshmitarë, t'i shohin provat dhe të kenë përfaqësim ligjor. Të pandehurit kanë të drejtë të ankohen. Këto të drejta u ofrohen të gjithë qytetarëve pa përjashtim. Vendi nuk mban gjykime me juri.

Kushtetuta garanton të drejtën për ndihmë juridike falas, por vëzhguesit ndërkombëtarë raportuan se Agjencia për ndihmë juridike falas, e autorizuar për të ofruar ndihmë juridike falas për personat me të ardhura të ulëta, nuk financohej siç duhej dhe nuk funksionoi siç ishte paraparë. Kjo agjenci ofron ndihmë juridike falas, por nuk i përfaqëson rastet në gjykatë.

TË BURGOSURIT DHE TË ARRESTUARIT POLITIKË

Nuk pati raportime për të burgosur apo të arrestuar politikë.

PROCEDURAT DHE MJETET JURIDIKE CIVILE

Pati mjete juridike civile për shkelje të të drejtave të njeriut, por viktimat nuk mund ta shfrytëzonin këtë të drejtë për shkak të procedurave të ndërlikuara burokratike dhe numrit të madh të rasteve të pazgjidhura gjyqësore. Individët mund të ankohen në gjykata për të kërkuar dëmshpërblim për shkelje të të drejtave të njeriut, apo ndalim të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Individët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e të drejtave të tyre për proces të drejtë. Kushtetuta i përfshin si të detyrueshme obligimet e rëna dakord në konventa të shumta ndërkombëtare. Individët mund ta paraqesin në Gjykatë Kushtetuese shkeljen e këtyre konventave, si dhe shkeljet e procesit të drejtë sipas ligjeve vendore.

KOSOVA

RIKTHIMI I PRONËS

Një përzierje konfuze e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe praktikave gjyqësore, si dhe rizënia ilegale e pronave dhe ankesat e shumta për të njëjtën pronë vazhduan ta pengonin zgjidhjen e rasteve të rikthimit të pronës që buronin nga lufta e vitit 1998-99. Qytetarët privatë dhe komunitetet fetare nuk ishin shumë të suksesshëm në paraqitjen e kërkesave për rikthim të pronës së sekuestruar apo konfiskuar gjatë epokës jugosllave.

Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), e themeluar në vitin 2016, ka autoritet për të vendosur për të vendosur për kërkesa përmes zgjidhjes së dallimeve në mes të dokumenteve kadastrale të dërguara në Serbi në vitin 1999 dhe të dhënave aktuale kadastrale të Kosovës. Parashtruesit e kërkesave kanë të drejtë të ankohen kundër vendimeve në gjykata.

Deri në dhjetor të vitit 2016, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës, që është nën AKKVP, kishte vendosur për 42.114 kërkesa të regjistruara, dhe autoritetet njoftuan shumicën e parashtruesve të kërkesave për rezultatet. Komisioni raportoi se autoritetet e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) kishin zbatuar 39.693 vendime të saj. Gjithsej 1.293 vendime të saj ishin në apel në Gjykatën Supreme.

AKP-ja, një organ kuazi-ligjor, kishte vështirësi në zbatimin e vendimeve të veta gjatë dëbimit të zaptuesve të paligjshëm. AKP-ja gjithashtu kishte mungesë të fondeve për ta paguar shumën prej 3,2 milionë eurove (3,8 milionë dollarë) në emër të dëmshpërblimit për 143 raste të vendosura në favor të personave që i kishin humbur pronat e tyre në fillim të viteve 1990 për shkak të praktikave diskriminuese banesore që zbatoheshin aso kohe. Agjencia kishte mungesë të fondeve për t'i larguar strukturat e paligjshme të ndërtuara në pronë pasi parashtruesve të kërkesës u ishte konfirmuar e drejta e tyre për pronën. Deri në gusht, agjencia kishte dorëzuar në prokurori 416 kallëzime penale kundër zaptuesve të paligjshëm të cilët i kishin rizënë pronat pas dëbimeve të kryera nga AKP-ja. 460 urdhra për dëbim ishin në pritje gjatë kësaj periudhe. Mitrovica ishte rajoni me përqindjen më të lartë të dëbimeve në pritje, me 337 raste, që ndikonin kryesisht në shqiptarët e Kosovës.

Numri i pazgjidhur i rasteve në gjykata komunale mbeti i lartë dhe rreth 50% e tyre kishin të bënin me kërkesa pronësore. Rreth 9.000 kërkesa mbetën pa u zgjidhur që nga dhjetori i vitit 2016, shumica prej tyre ishin kërkesa të serbëve të Kosovës për kompensim për pronën e pabanueshme të dëmtuar nga lufta. Vendit i mungonte një sistem efektiv për t'u mundësuar serbëve të zhvendosur nga Kosova, që jetonin jashtë vendit, për të paraqitur kërkesa pronësore dhe kërkesa të tjera.

f. Ndërhyrja arbitrare ose e paligjshme në intimitet, familje, shtëpi apo korrespondencë

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë veprime të tilla dhe nuk pati raportime që Qeveria, EULEX-i apo KFOR-i nuk i respektuan këto ndalesa.

Seksioni 2. Respektimi i lirive civile, përfshirë:

a. Lirinë e fjalës dhe të shtypit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e shprehjes, përfshirë lirinë e shtypit. Ndonëse Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta, pati raportime që disa zyrtarë publikë, politikanë, biznese dhe grupe radikale fetare përpiqeshin t'i kërcënonin përfaqësuesit e mediave. Mediat gjithashtu hasën në vështirësi me rastin e marrjes së informatave nga Qeveria dhe institucionet publike, siç parashihej me ligj. Një Komision i Pavarur për Media i rregullon frekuencat e transmetimit, u lëshon leje transmetuesve publikë e privatë dhe përcakton politika transmetuese.

Më 26 prill, Ministria e Drejtësisë propozoi nene që e kriminalizojnë shpifjen dhe fyerjen e Presidentit dhe të zyrtarëve të tjerë të lartë. Personat që e shkelin këtë nen do të dënohen prej tre muaj deri në pesë vjet burgim. Pas kritikave nga shoqëria civile, mediat dhe bashkësia ndërkombëtare, Ministria e Drejtësisë shfuqizoi ndryshimet e propozuara.

Liria e shtypit dhe e mediave: Mediat e pavarura ishin aktive dhe shprehën një gamë të gjerë të pikëpamjeve, në përgjithësi pa kufizim, edhe pse pati raportime për presion verbal nga zyrtarët qeveritarë, disa parti politike, biznese të lidhura me Qeverinë, grupe fetare dhe disa individë të pakënaqur ndaj pronarëve të mediave, redaktorëve individualë dhe reporterëve për të mos publikuar storje apo materiale të caktuara.

Rritja e vështirësive financiare të medimeve e vuri në rrezik pavarësinë redaksionale të të gjitha mediave. Përderisa disa medime financiarisht të pavarura zhvilluan politika redaksionale të pavarura nga interesat politike dhe të biznesit, medimet me më pak burime nganjëherë pranuan ndihmë financiare në shkëmbim për raportim pozitiv apo mospublikim të storjeve negative që do të mund t'i dëmtonin interesat e financuesve.

Mediat transmetuese, veçanërisht kanalet televizive, kishin më tepër qasje në burime substanciale të të ardhurave sesa mediat e shkruara. Kuvendi kontrollonte buxhetin e transmetuesit publik, RTK, dhe të degëve të tij. Publiku i perceptonte transmetuesit privatë si më të pavarur sesa mediat shtetërore, por stacionet e vogla raportnin se vazhdimisht përballeshin me rrezikun e mbylljes dhe gjithnjë e më shumë vareshin nga burimet më të pakta të financimit të jashtëm. Mediat e internetit, që operonin pa rregullore, ushtronin trysni të mëtejme mbi mediat transmetuese duke ribotuar artikuj nga shtypi ose burime të tjera të internetit, kryesisht pa e cekur burimin.

Dhuna dhe ngacmimi: Deri më 25 gusht, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe mediat raportuan për 20 raste në të cilat zyrtarë qeveritarë, grupe të interesit afarist ose grupe radikale fetare abuzuan me lirinë e shtypit, përfshirë sulmet fizike dhe kërcënimet verbale ndaj gazetarëve, dhe presionin ndaj mediave për të mos publikuar materiale të caktuara.

Më 16 gusht, persona të panjohur e sulmuan Parim Ollurin, drejtor i portalit të lajmeve Insajderi, duke i shkaktuar lëndime të lehta. Olluri i tha kanalit televiziv Dukagjini se besonte që sulmi ishte përgjigje ndaj një artikulli të publikuar, në të cilin kritikoheshin komandantët e UÇK-së.

KOSOVA

Më 4 shtator, Insajderi raportoi se anëtarë i Kuvendit, Bekë Berisha, kërcënoi se do ta vriste kryeredaktorin e tij, Vehbi Kajtazi, për shkak të një artikulli që portali e kishte botuar, në të cilin pohohej se këshilltari i sapoemëruar i Kryeministrit, Gazmend Syla, kishte lidhje me grupe kriminale. Artikulli gjithashtu pohonte që Berisha kishte qenë i dënuar për vrasjen e fqinjit të vet para vitit 1999. AGK e dënoi sulmin.

Censurimi ose kufizimi i përmbajtjes: Nuk kishte raporte për censurim të drejtpërdrejtë të mediave të shkruara apo elektronike; megjithatë, gazetarët pohonin që presioni nga politikanët dhe grupet e organizuara kriminale shpesh rezultonte në vetëcensurim. Disa gazetarë përmbaheshin nga raportimi hetues kritik për shkak të frikës për sigurinë e tyre personale apo vendin e tyre të punës. Gazetarët nganjëherë pranonin oferta për përfitime financiare në këmbim për raportim pozitiv apo heqje dorë nga hetimi. Sipas AGK-së, zyrtarët qeveritarë, si dhe kriminelë të dyshuar, gojarisht i kërcënonin gazetarët për raportimin që konsiderohej negativ. Sipas disa redaktorëve, agjencitë qeveritare dhe korporatat i tërhiqnin reklamat nga gazetaret që publikonin material kritik për to.

Gazetarët u ankuan që pronarët dhe menaxherët e mediave nuk i lejonin të publikonin apo transmetonin storje kritike për Qeverinë, partitë politike apo zyrtarë të caktuar. Në disa raste, gazetarët raportonin që pronarët i kërcënonin se do t'i largonin nga puna nëse vazhdonin të publikonin raporte kritike. Gazetarët gjithashtu u ankuan se pronarët i ndalonin të raportonin për korrupsion të nivelit të lartë në Qeveri.

LIRIA E INTERNETIT

Qeveria nuk e kufizoi apo ndërpreu qasjen në internet apo censuroi përmbajtjen në internet, dhe nuk pati raportime të besueshme që Qeveria i monitoronte bisedat private në internet pa autoritet përkatës ligjor.

Deri në gusht, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare raportoi se rreth 79 për qind e të gjitha amvisërive kishin lidhje interneti.

LIRIA AKADEMIKE DHE NGJARJET KULTURORE

Qeveria nuk e kufizonte lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

b. Liria e tubimit paqësor dhe asociimit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e tubimit paqësor dhe asociimit, dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto të drejta.

c. Liria e fesë

Shih *Raportin ndërkombëtar mbi liritë fetare* të Departamentit të Shtetit në: www.state.gov/religiousfreedomreport/.

d. Liria e lëvizjes

KOSOVA

Ligji parashikon lirinë e lëvizjes brenda vendit, udhëtimin jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhësimin, dhe Qeveria e EULEX-i në përgjithësi i respektuan këto të drejta. Megjithatë, tensionet ndëretnike, barrikatat e vendosura nga ekstremistët dhe brengat e vërteta e të perceptuara të sigurisë e kufizonin lirinë e lëvizjes. Brengat e sigurisë gjithashtu kufizuan numrin e serbëve të zhvendosur të Kosovës që kërkonin të ktheheshin.

Qeveria bashkëpunoi me UNHCR-në dhe organizata të tjera humanitare për t'u ofruar mbrojtje dhe ndihmë personave të zhvendosur brenda vendit, refugjatëve, refugjatëve që ktheheshin, azilkërkesve, personave pa shtetësi dhe komuniteteve pakicë të cenuara.

Lëvizjet brenda vendit: Liria e lëvizjes në urën Austerlitz që lidh Mitrovicën veriore dhe jugore u pengua edhe përkundër marrëveshjes së vitit 2016 mes kryeministrit të Kosovës dhe kryeministrit të Serbisë që ura të hapet. Kryetari i Mitrovicës veriore ndaloi punët ndërtimore në pjesën veriore të urës kryesore në prill duke cituar shkaqet e sigurisë dhe rritjen e incidenteve ndëretnike. Deri në shtator, puna nuk rifilloi. Ura Austerlitz mbeti e hapur për këmbësorë, dhe urat e tjera që i lidhin Mitrovicën veriore dhe jugore mbetën plotësisht të hapura.

Në dhjetor të vitit 2016, autoritetet e komunës së Mitrovicës veriore filluan ndërtimin e një muri të betonit afër urës kryesore në Mitrovicë, gjë që përkeqësoi lirinë e lëvizjes dhe ngriti tensionet mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Vëzhguesit ndërkombëtarë pohuan se qeveria serbe kishte urdhëruar këtë ndërtim. Qeveria e Kosovës e konsideronte ndërtimin e murit shkelje të marrëveshjes së vitit 2015, të mbështetur nga BE-ja, mes Kosovës dhe Serbisë. Në shkurt, kryetari i Mitrovicës veriore, Goran Rakiq, dhe ministri i Planifikimit Hapësinor, Ferat Shala, nënshkruan një marrëveshje për heqjen e murit. Qeveria e Mitrovicës veriore më pas e hoqi murin, por zbatimi i plotë i marrëveshjes së vitit 2015 ende mbeti pezull.

Qeveria nuk i konsideronte dokumente të vlefshme udhëtimi dokumentet personale të lëshuara nga Serbia me emra të qyteteve të Kosovës, duke e vështirësuar kështu lirinë e lëvizjes për shumë anëtarë të komunitetit serb të Kosovës. Qeveria ndërmori hapa për ta korrigjuar këtë problem duke miratuar një udhëzim administrativ që mundësoi qasje më të lehtë në dokumente personale të lëshuara nga qeveria për qytetarët që nuk ishin të regjistruar më parë në sistemin e vendit, por dështoi ta lëshonte një udhëzim përfundimtar që zyrat e gjendjes civile ta jetësonin këtë udhëzim administrativ. Serbët e Kosovës që posedonin vetëm dokumente personale të lëshuara nga Serbia nuk mund t'i merrnin letërnjoftimet e Kosovës ose të regjistroheshin si shtetas të Kosovës.

Mërgimi: Kthimi i refugjatëve ashkalinj, egjiptianë dhe romë, të zhvendosur nga lufta e vitit 1999, mbeti problem. Përfaqësuesit e tyre institucionalë besonin që paragjykimi shoqëror e pengonte kthimin e rreth 400 ashkalinjëve, egjiptianëve dhe romëve, që më parë ishin banorë të këtij vendi, dhe i thanë UNHCR-së se ishin të gatshëm të ktheheshin nga Maqedonia dhe Mali i Zi.

Ministria për Komunitete dhe Kthime raportoi se deri në shtator, komisioni ndërministror të cilin e kryesonte për ta ndihmuar procesin e kthimit nuk kishte bërë përparim të madh në themelimin e një paneli të posaçëm gjyqësor për t'i shqyrtuar kërkesat e personave të zhvendosur në mënyrë që ta rimerrnin pronën e tyre të zaptuar më herët. Ministria

KOSOVA

gjithashtu vuri në pah se personat e zhvendosur ende kishin vështirësi në nxjerrjen e dokumenteve personale dhe në shërbime kadastrale nga komunat.

PERSONAT E ZHVENDOSUR BRENDË VENDIT (PZHBV)

Sipas UNHCR-së, 106.000 persona, banorë të Kosovës, mbetën të zhvendosur nga lufta dhe pasojat e saj në shtetet fqinje. Gjithsej 8.367 persona të zhvendosur (2.104 familje), kryesisht serbë të Kosovës, ia kishin shprehur UNHCR-së interesimin e tyre për t'u kthyer në Kosovë. Prej tyre, 307 persona ishin kthyer deri më 31 tetor. Qeveria vazhdimisht i ftonte të gjithë personat e zhvendosur të ktheheshin; megjithatë, kishte pengesa lidhur me ndarjen e tokës për rindërtimin e shtëpive, fonde të kufizuara dhe mungesë të prospekteve socio-ekonomike. Sipas UNHCR-së, mungesa e regjistrimit të detajuar dhe e të dhënave përkatëse mbi profilin e tyre i lanë PZHBV-të të përjashtuar nga mbrojtjet e të drejtave të njeriut dhe planet për zhvillim.

Procesi i kthimit në disa zona të vendit vazhdoi të pengohej nga incidentet e sigurisë ose nga ngurrimi i komuniteteve lokale për t'i pranuar pakicat që ktheheshin. Deri më sot, asnjë serb i Kosovës nuk është kthyer në Gjakovë. UNHCR-ja vërejti mundësi të kufizuara ndërveprimi mes të kthyerve dhe komuniteteve pranuese, si dhe mungesën e besimit tek të kthyerit në organet për zbatim të ligjit. Përveç kësaj, kthimi i pakicave shoqërohej me vështirësi të sigurisë, dhe zyrtarët në Istog, Klinë, Mamushë, Mushtisht dhe Mitrovicë veriore shpesh i dekurajonin kthimet. UNHCR-ja raportoi për vonesa të mëdha në ofrimin e ndihmës për riintegrimin e të kthyerve që ktheheshin vullnetarisht. Pas një nisme të UNHCR-së dhe OSBE-së për ta trajtuar problemin me të cilin përballeshin të kthyerit e Kosovës u mbajtën dy takime gjatë vitit, por nuk ishte ndarë buxhet dhe nuk ishin ndërmarrë hapa konkretë.

Përkundër thirrjeve zyrtare për kthim të personave të zhvendosur, qeveria nuk ndërmori hapa për t'i eliminuar pengesat për riposedim ose ndihmë për ndërtim të shtëpive. Pengesat e tilla përfshinin ndarjen e tokës për ndërtim të shtëpive, problemet e sigurisë në disa zona, dhe mungesën e përgjithshme të prospekteve socio-ekonomike për të kthyerit. UNHCR-ja pohonte që programet qeveritare për riintegrim të personave të zhvendosur nuk patën sukses për shkak të mungesës për vlerësim të mirëfilltë të nevojave dhe për shkak të dështimit për t'i përzgjedhur dhe për t'u dhënë prioritet përfituesve bazuar në cenueshmëri.

UNHCR-ja raportoi se Policia e Kosovës mbajti një prani të shtuar në zonat me të kthyer për ta penguar dhunën ndëretnike. UNHCR-ja i regjistroi 10 incidente të dhunës ndaj të kthyerve gjatë vitit dhe shtatë kundër PZHBV-e.

Më 6 janar -- nata e krishtlindjes ortodokse -- rreth 12 aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje protestuan kundër vizitës së 50 pelegrinëve të zhvendosur serbë të Kosovës në kishën ortodokse serbe në Gjakovë. Protestuesit gjuajtën gurë dhe ngjyrë të kuqe në autobusin e vizitorëve, me ç'rast dëmtuan një dritare dhe shënuan me ngjyrë fjalën "vrasës" në muret e jashtme të kishës. Policia e Kosovës i shpërndau protestuesit dhe arrestoi shtatë persona për mosbindje të urdhrave të policisë dhe vandalizëm.

KOSOVA

Në prill, banorët vendës protestuan kundër kthimit të 13 PZHBV-e serbë në vendin e tyre të prejardhjes, në Lubozhdë. Ministria për Komunitete dhe Kthime i strehoi përkohësisht PZHBV-të gjersa konsideronte ta financonte rindërtimin e shtëpive të tyre familjare.

Në prill, Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut i OKB-së e shpalli UNMIK-un përgjegjës për shkelje të të drejtave të njeriut lidhur me helmimin me plumb në kampet e romëve pas konfliktit të vitit 1999. OKB-ja u zotua ta themelonte një fond mirëbesimi për ta financuar përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, zhvillimin ekonomik dhe projekte të infrastrukturës në Mitrovicën veriore e jugore dhe në Leposaviq, ku edhe jetonin personat e prekur. OKB-ja nuk i kompensoi romët dhe komunitetet e tjera pakicë në Kosovë përkundër nxitjes nga organizatat për të drejta të njeriut.

MBROJTJA E REFUGJATËVE

E drejta për azil: Ligji parashikon dhënien e statusit të azilantit apo refugjatit. Qeveria ka një sistem për t'u ofruar mbrojtje refugjatëve, por sipas UNHCR-së, asaj i mungonin mekanizmat dhe praktikat efikase për identifikimin e personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe për gjetjen e vendit të origjinës së personave pa dokumente. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, asnjëra prej 1.038 kërkesave për azil të shqyrtuara në mes viteve 2008 dhe qershorit nuk ka rezultuar në dhënien e statusit të refugjatit, ndonëse vetëm 13 persona kanë marrë mbrojtje shtesë gjatë kësaj periudhe. Deri në nëntor, 231 kërkesa për azil pritnin të shqyrtoheshin. Të gjithë azilkërkuesit largoheshin nga vendi para se kërkesat e tyre të shqyrtoheshin.

Autoritetet i transferuan në qendër të azilit të gjithë të huajt që kapeshin gjersa i kalonin ilegalisht kufijtë dhe që më pas kërkonin azil. Vëzhguesit e pavarur kishin qasje në këtë qendër. UNHCR-ja raportoi se qendra u siguronte azilkërkuesve akomodim, shujta të rregullta dhe veshmbathje, ndërsa organizatat partnere të UNHCR-së ofronin vlerësim psikologjik, shërbime këshillimi dhe ndihmë juridike. Mungesa e shërbimeve të përkthimit në disa gjuhë mbeti problem.

Objektet e pranimit në qendrën për azil mund të pranojnë fëmijë, por objektit i mungonin procedurat standarde të operimit për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar që kërkonin azil dhe për përcaktimin e të drejtës për azil.

Vendi i sigurt i origjinës/Transiti: Ligji e pranon konceptin vend i sigurt i origjinës sipas të drejtës ndërkombëtare, por ai duhet të zbatohet. Sipas UNHCR-së, përkufizimi vend i sigurt i origjinës është në përputhje me standardet e BE-së.

Mbrojtja e përkohshme: Qeveria gjithashtu u siguroi mbrojtje të përkohshme, të ashtuquajtur mbrojtje shtesë, individëve që mund të mos kualifikohen si refugjatë. Që nga pavarësia në vitin 2008 e deri në qershor, qeveria u ofroi mbrojtje shtesë 13 personave.

PERSONAT PA SHTETËSI

Shifrat zyrtare për persona pa shtetësi nuk ishin në dispozicion. Ligji nuk përmban dispozita diskriminuese të cilat mund të shkaktojnë që grupeve apo individëve t'u hiqet apo mohohet shtetësia. Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo për shkak të

KOSOVA

lindjes në vend në rastet e fëmijëve të lindur nga prindërit e komuniteteve të caktuara pakicë.

Procedurat e qeverisë parashikojnë qasje në natyralizim për personat që marrin statusin e personit pa shtetësi apo të refugjatit pesë vjet pas paraqitjes së kërkesës.

Ligjet që kanë të bëjnë me gjendjen civile u mundësojnë personave pa shtetësi t'i regjistrojnë lindjet, martesat dhe vdekjet, zbatimi i tyre ndryshonte nga komuna në komunë. Kapaciteti i qeverisë për t'i identifikuar personat pa shtetësi dhe personat me shtetësi të papërcaktuar mbeti joadekuat.

Gjatë vitit, UNHCR-ja ndihmoi 360 romë, ashkalinj dhe egjiptianë të paregjistruar. Anëtarët e paregjistruar të familjeve nuk merrnin ndihma sociale, nuk kishin të drejtë në pension dhe nuk mund të regjistroheshin si titullarë të pronës apo të bartnin të drejta mbi pronën e trashëguar apo të transferuar. Fëmijët e lindur nga prindërit e zhvendosur jashtë vendit dhe që hynin me prindërit e tyre të pranuar shpesh nuk kishin dokumente, përfshirë certifikatat e lindjes, nga vendi i tyre i lindjes. Autoritetet pranuan se kjo paraqiste problem, por nuk dolën me ndonjë zgjidhje sistematike. Në vitin 2015, Agjencia e Regjistrimit Civil, që vepron në kuadër të MPB-së, promovoi regjistrimin e lindjes pa pagesë dhe regjistrimin e vonshëm duke hequr datën e skadimit, që do të shkaktonte pagesa të taksave administrative apo gjoba për shumë shërbime regjistrimi për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët.

Në gusht, MPB raportoi që 618 ashkalinj, egjiptianë dhe romë ishin “ligjërisht të padukshëm” për shkak të pamundësisë së tyre për të ofruar dëshmi për lindjen e tyre në vend. Gjatë vitit, Agjencia e Regjistrimit Civil u lëshoi certifikata të lindjes, letërnjoftime dhe/ose pasaporta 924 personave të zhvendosur nga Kosova, që jetonin në Mal të Zi..

Serbët e Kosovës në katër komunat veriore u ankuan se nuk mund t'i regjistrojnë lindjet, martesat apo shkurorëzimet dhe të merrnin dokumente zyrtare të Kosovës sepse dokumentet e tyre ekzistuese ishin regjistruar vetëm me sistemin paralel të Qeverisë së Serbisë. Gjatë këtij viti, qeveria punoi për të themeluar zyra të regjistrimit civil në zonat me shumicë serbe në veri të vendit, ndonëse ata janë përpjekur t'i hapin ato dhe ta zbatojnë një marrëveshje të re për ta lejuar regjistrimin. Në fund të vitit 2016, Agjencia e Regjistrimit Civil njoftoi se qytetarët që më parë ishin të regjistruar në sistemin e vendit mund t'i përtërinin letërnjoftimet, pasaportat, patentë shoferët dhe regjistrimin e automjeteve në komunat me shumicë serbe në Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan dhe Mitrovicë.

Seksioni 3. Liria për pjesëmarrje në procesin politik

Ligji parashikon të drejtën e qytetarëve për ta zgjedhur qeverinë e tyre përmes zgjedhjeve periodike të lira e të drejta, me votim të fshehtë, në bazë të votimit të përgjithshëm e të barabartë.

Përkundër përpjekjeve për t'i shpërbërë, qeveria serbe vazhdoi t'i drejtonte disa struktura paralele ilegale qeveritare në komunat me shumicë serbe. Institucionet paralele ilegale gjithashtu vazhduan të vepronin në enklavat serbe e gorane në pjesën jugore të vendit.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Zgjedhjet e fundit: Zgjedhjet parlamentare - përfshirë Kosovën veriore – u mbajtën më 11 qershor. Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe të pavarur e vlerësuan votimin në përgjithësi të drejtë e të lirë. Megjithatë, fushata u përshkua me kërcënime brenda komunitetit serb të Kosovës, pasi disa serbë të Kosovës ushtronin trysni në personat që mbështetnin parti të tjera, e jo Listën Serbe (LS). Kandidatët që nuk ishin pjesë e LS-së kërcënoheshin të tërhiqeshin nga gara. Pati incidente të izoluar të dhunës, përfshirë sulmin me armë zjarri ndaj zyrës së Partisë së Serbëve të Kosovës (PKS) në Leposaviq më 22 maj, dhe një përleshje e dhunshme mes mbështetësve të PKS-së dhe LS-së, që rezultoi në ndalimin e përkohshëm të liderit të PSK-së, më 4 qershor.

Vonesa në formimin e një koalicioni qeverisës shkaktoi pengesa në themelimin e institucioneve qeveritare për nëntë javë pas zgjedhjeve parlamentare, gjë që ndikoi negativisht në ekonominë e vendit dhe e pengoi përparimin në çështje kyçe në marrëdhëniet ndërkombëtare e vendore.

Më 22 tetor, Kosova i mbajti zgjedhjet komunale, të cilat vëzhguesit i konsideruan në përgjithësi të lira e të drejta, përkundër disa parregullsive të izoluar. Periudha parazgjedhore u shënua me disa incidente të kërcënimit brenda komunitetit serb të Kosovës. Para zgjedhjeve lokale, kandidati për kuvend të Skenderajt, Beqir Veliu, u sulmua fizikisht. Sulmi ishte politikisht i motivuar.

Partitë politike dhe pjesëmarrja politike: Lidhja partiake luante rol të madh në qasje në shërbime qeveritare e sociale dhe në mundësi për punësim. Besnikëritë klanore gjithashtu luanin rol të madh në organizatat politike. Përfaqësimi i pakicave etnike në Kuvend nuk ishte në proporcion me përqindjen e përgjithshme të popullatës, por partitë politike që i përfaqësonin pakicat etnike i kritikuan partitë shumicë për moskonsultim me to për çështje të rëndësishme. Incidentet e dhunshme të shkaktuara nga deputetët e disa partive në Kuvend, që ndodhën në vitin 2016, nuk u përsëritën këtë vit.

Pjesëmarrja e femrave dhe pakicave: Asnjë ligj nuk e kufizon pjesëmarrjen e femrave dhe të pakicave në procese politike, dhe ato morën pjesë në to.

Seksioni 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në Qeveri

Ligji parashikon dënime penale për korrupsion kundër zyrtarëve, por Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efikase dhe korrupsioni mbeti problem serioz. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit i kontribuuan këtij problemi. Rastet e korrupsionit shpesh i nënshtroheshin apelimit të përsëritur, dhe sistemi gjyqësor shpesh lejonte parashkrimin e rasteve pa i gjykuar ato.

Korrupsioni: Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit (AKK) dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ndanë përgjegjësinë për luftimin e korrupsionit në qeveri. Deri në qershor, PSRK-ja pranoi 38 raste nga AKK-ja. AKK-ja dërgoi një rast në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë. Dënimet për akuza për korrupsion vazhduan të paraqisnin një përqindje të vogël të personave të hetuar dhe të akuzuar.

KOSOVA

Një raport i OJQ-ve Çohu dhe Komunikimi për Zhvillimin e Shoqërisë identifikoi dështime të shumta të sistemit të drejtësisë në ndjekjen e korrupsionit. Raporti theksoi se vetëm 13 prej 140 rasteve të ngritura kundër zyrtarëve të lartë rezultuan në aktakuza. OJQ-ja Instituti i Kosovës për Drejtësi raportoi se prokurorët hodhën 55 për qind të rasteve të korrupsionit në katër muajt e parë të vitit. Dënimi i zyrtarëve të nivelit të lartë të dënuar për korrupsion shpesh ishte i ulët. Instituti raportoi se aktakuzat shpesh dështonin për shkak se prokurorët ushtronin kallëzime të gabuara ose bënë gabime procedurale.

Më 8 maj, Prokuroria Themelore e Pejës ngriti aktakuzë kundër kryetarit të Pejës, Gazmend Muhaxheri, për mosekzekutim të vendimit të Gjykatës së Apelit për ta rikthyer në punë një nëpunës pasi gjykata vendosi që nëpunësi ishte i mbrojtur nga dispozitat për informatorë. Në maj, PSRK-ja inicioi një hetim kundër Muhaxherit dhe tre nëpunësve komunalë për llogaritje të padrejtë të një kontrate të sigurimit në vlerë prej 152.000 eurove (182.000 dollarë).

Zbulimi financiar: Ligji i obligon të gjithë zyrtarët e lartë publikë dhe anëtarët e familjeve të tyre që ta deklarojnë pasurinë e tyre dhe prejardhjen e pasurisë së tyre në baza vjetore. Zyrtarët e lartë duhet t'i raportojnë edhe ndryshimet në pasuri kur e fillojnë apo ndërpresin shërbimin e tyre publik. AKK-ja administron këto të dhëna, verifikon zbulimet dhe i publikon ato në uebfaqen e vet. Agjencia raportoi se rreth 98 për qind e zyrtarëve deklaruan pasurinë dhe të ardhurat e tyre. Autoritetet mund t'i gjobisin zyrtarët e akuzuar për shkelje të vogla të kriterëve apo t'ua ndalojnë ushtrimin e funksioneve publike deri në një vit. AKK-ja ua dërgoi prokurorëve të gjitha kallëzimet penale kundër personave që nuk e kishin deklaruar pasurinë.

Seksioni 5. Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut

Një numër i madh i grupeve vendëse dhe ndërkombëtare për të drejta të njeriut në përgjithësi punuan pa u kufizuar nga qeveria, duke hetuar dhe publikuar konkluzionet e veta për rastet e të drejtave të njeriut. Qeveria bashkëpunonte dhe deri diku u përgjigjej pikëpamjeve të tyre.

Organet qeveritare për të drejta të njeriut: Institut i Avokatit të Popullit (IAP) ka kompetencë për t'i hetuar pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut dhe abuzim të autoritetit qeveritar, dhe vepron si mekanizëm kombëtar parandalues kundër torturës. IAP-i është agjencia kryesore përgjegjëse për monitorimin e institucioneve të ndalimit, shtatë zyrat e tij në terren ia mundësuan mbajtjen e kontaktit me të gjitha komunat e vendit. Në rastet kur rekomandimet e tij nuk përfillen, ai mund të ngrejë raste kundër organeve qeveritare në gjykatë, përfshirë Gjykatën Kushtetuese. Në bazë të kompetencave të dhëna nga Kuvendi, deri më 14 dhjetor, IAP-i paraqiti tri raste *amicus curiae* në Gjykatën Kushtetuese. IAP gjithashtu mund të japë rekomandime mbi përshtatshmërinë e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore ose administrative, udhëzimeve dhe praktikave.

Seksioni 6. Diskriminimi, abuzimet shoqërore dhe trafikimi i personave

Gratë

Dhunimi dhe dhuna në familje: Ligji e konsideron dhunimin vepër penale, por nuk e trajton dhunimin bashkëshortor në mënyrë të posaçme. Sipas ligjit, dhunimi dënohet prej 2 – 15 vjet burg.

EULEX-i vuri në pah se gjykatat shpesh shqiptonin dënime më të buta sesa dënimi më i ulët ligjor për rastet e dhunimit, veçanërisht për rastet kur viktimat ishin të mitur. EULEX-i gjeti se gjykatat rrallë ndërmermin hapa për t'i mbrojtur viktimat dhe dëshmitarët, dhe nuk i mbyllnin seancat dëgjimore për publikun siç kërkohet me ligj. Një sektor i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ndihmoi për t'u mundësuar qasje në drejtësi viktimave të të gjitha krimeve, me fokus të veçantë në dhunën në familje, trafikimin e personave, abuzimin e fëmijës dhe dhunimin.

Ligji e trajton dhunën në familje si çështje civile, nëse viktimat nuk ka pësuar lëndime trupore. Mosrespektimi i aktgjykimit të një gjykate civile që ka të bëjë me dhunën në familje është vepër penale dhe mund të ndiqet penalisht, ndonëse ndjekjet penale për raste të tilla ishin të rralla. Sipas Rrjetit të Grave të Kosovës, më shumë se dy të tretat e grave kishin qenë viktimat të dhunës në familje. Kur viktimat ngrinin padi, njësitë policore për dhunë në familje kryenin hetime dhe ua kalonin rastet prokurorëve, sadoqë shkalla e ndjekjes penale ishte e ulët. Avokatët e viktimave dhe vëzhguesit e gjykatave pohuan se prokurorët dhe gjykatësit parapëlqenin bashkimin e familjes më shumë se mbrojtjen e viktimave, me urdhra mbrojtës nganjëherë ia lejonin kryesit të veprës të qëndronte në shtëpinë familjare derisa rasti ishte në procedurë. Dënimet shpesh ishin të buta dhe sillleshin prej qortimeve gjyqësore deri në dënime me burg prej dy muaj deri në 5 vjet.

Sistemi gjyqësor i Kosovës miratoi procedura të reja standarde të operimit dhe e përmirësoi detyrën parësore të prokurorëve për rastet e dhunës në familje gjatë vitit. Ligji u lejon individëve që ndihen të kërcënuar të kërkojnë urdhër mbrojtës, por shkelja e urdhrit mbrojtës rrallëherë shpuri në kallëzime penale. Gjykatat rrallë u shqiptuan recidivistëve dënime më të larta siç kërkohet me ligj.

Më 21 gusht, Gjykata Themelore e Prizrenit miratoi apelin e prokurorisë në rastin e vrasjes së Zejnepe Berishës, e mbytur me thikë nga bashkëshorti i saj Nebih Berisha, në vitin 2015, dhe e rriti dënimin me burg prej 12 në 17 vjet. Pas reagimeve të shumta të mediave, shoqërisë civile dhe protestave nga organizatat për të drejtat e gruas, prokuroria u ankua që dënimi ishte shumë i butë. Vrasja e Zejnepe Berishës ndodhi pas një historie të gjatë të dhunës në familje. Ajo e kishte raportuar bashkëshortin e vet në polici së paku 16 herë para vdekjes së saj. Aktivistët e konsideruan dënimin fillestar si shumë të butë, sepse korniza ligjore e vendit parasheh dënim prej 10 vjet deri në burgim të përjetshëm për vrasjen e një anëtari të familjes.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përfshiu një njësi kushtuar dhunës në familje. Qeveria dhe donatorët ndërkombëtarë siguruan mbështetje për shtatë OJQ për t'u ndihmuar fëmijëve dhe femrave viktimat të dhunës në familje. Në Kosovë ishin 10 strehimore për viktimat e dhunës në familje.

KOSOVA

Më 27 prill, qeveria themeloi një komision të pavarur për verifikimin dhe njohjen e statusit të të mbijetuarit të dhunës seksuale gjatë luftës. Të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës u ankuan se prokurorët e EULEX-it nuk e ndoqën penalisht asnjë rast me sukses. Ministria e Drejtësisë udhëhoqi një grup punues, përfshirë EULEX-in dhe PSRK-në, për t'u dhënë përparësi rasteve, por asnjë veprim nuk është ndërmarrë në asnjë rast.

Ngacmimi seksual: Në procedura civile, ligji e përkufizon ngacmimin seksual. Ndonëse Kodi Penal e përfshin ngacmimin seksual, ai nuk përmban një standard ose përkufizim specifik. Kodi parashikon dënime të larta për ngacmim seksual kundër viktimave të cenueshme, përfshirë viktimat e abuzimit seksual. Procedurat dhe rregulloret e ndryshme të brendshme për raportim të ngacmimit seksual e penguan zbatimin e këtyre ligjeve.

Sipas organizatave për të drejta të gruas, ngacmimi seksual në vend të punës ishte i rëndomtë.

Detyrimi në kontrollin e popullsisë: Nuk pati raporte për abortim të detyruar, sterilizim jovullnetar apo metoda të tjera detyruese për kontroll të popullsisë. Vlerësimet për vdekshmërinë e nënave dhe përhapjen e kontraktivëve janë në dispozicion në: www.who.int/reproductivehealth/publications/monitoring/maternal-mortality-2015/en/.

Diskriminimi: Ligji parasheh status dhe të drejta të njëjta për gra sikurse për burra. Ligji kërkon paga të njëjta për punën e njëjtë. Ligji përcakton që partnerët në martesë dhe bashkësi civile kanë të drejta të barabarta për të poseduar dhe trashëguar pronë, por meshkujt zakonisht e trashëgonin pronën e familjes. Në raste të rralla, të vejat shqiptare të Kosovës, posaçërisht në zonat rurale, rrezikonin ta humbnin kujdestarinë e fëmijëve të vet për shkak të një zakoni i cili kërkonte që fëmijët dhe prona t'i kaloheshin familjes së babait të ndjerë, ndërsa e veja të kthehej në familjen e saj amnore.

Relativisht pak femra fituan pozita udhëheqëse të nivelit të lartë në biznes, polici apo Qeveri.

Përzgjedhja e seksit mbi baza gjinore: Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2012, data e regjistrimit të fundit të popullsisë, raporti gjinor mes meshkujve dhe femrave të lindur në vend ishte 110,7 me 100. Sipas UNICEF-it, qeveria nuk ndërmori hapa për ta adresuar këtë çekuilibrim.

Fëmijët

Regjistrimi i lindjeve: Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo në bazë të lindjes në vend, për fëmijët e lindur nga prindërit e komuniteteve të caktuara pakicë, shtetësia e të cilëve nuk dokumentohej. Ata që nuk ishin regjistruar ishin kryesisht nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. UNICEF tregoi se mungesa e regjistrimit mund të ndikojë negativisht në qasjen në ndihma sociale, veçanërisht për fëmijët e riatdhesuar. Fëmijët që nuk ishin regjistruar konsideroheshin pa shtetësi.

Abuzimi i fëmijëve: Në vitin 2015, UNICEF-i gjeti që 30 për qind e fëmijëve në vend dhe 40 për qind e fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë ishin viktimat të abuzimit (shih data.unicef.org/topic/child-protection/violence/).

KOSOVA

Martesa e hershme dhe e detyruar: Ligji lejon që personat të martohen në moshën 16-vjeçare. Martesa e fëmijëve ishte e rrallë, por vazhdoi në disa komunitete, përfshirë romët, ashkalinjtë, egjiptianët dhe goranët. Sipas një raporti të veçantë të MICS-së që ishte përqendruar në këto komunitete, rreth 12 për qind e fëmijëve, kryesisht vajza, martoheshin para moshës 15 vjeçare.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Mosha minimale për marrëdhënie seksuale me pëlqim është 16 vjeç. Dhunimi i të miturës është vepër penale dhe dënohet prej 5 deri në 20 vjet burg. Ligji ndalon posedimin, prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë së fëmijëve. Personat që prodhojnë, përdorin apo përfshijnë një fëmijë në krijimin apo prodhimin e pornografisë mund të dënohen prej një deri në 5 vjet burg. Shpërndarja, promovimi, transmetimi, ofrimi apo paraqitja e pornografisë së fëmijëve dënohet prej gjashtë muaj deri në 5 vjet burg. Posedimi ose prokurimi i pornografisë së fëmijëve dënohet me të holla apo me burg deri në tri vjet.

Rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve: Vendi nuk është nënshkruar i Konventës së Hagës së vitit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës. Shih *Raportin vjetor mbi rrëmbimin ndërkombëtar prindëror të fëmijëve* të Departamentit të Shtetit në: travel.state.gov/content/childabduction/en/legal/compliance.html.

Antisemitizmi

Sipas komunitetit hebraik të Kosovës, në vend jetonin rreth 50 hebrenj. Në vitin 2016, Qendra Simon Wiesenthal në Francë lëshoi një letër publike drejtuar Presidentit, në të cilën kritikohet literatura famëkeqe antisemitike që ishte në dispozicion në vend, gjoja e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e botuar në Egjipt nga Vëllazëria Myslimane. Qendra Wiesenthal theksoi se kishte parashtruar ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në nëntor të viti 2016, Presidenti njoftoi për një vendim që ndalonte shitjen dhe shpërndarjen e librave antisemitikë. Asnjë veprim administrativ nuk ishte ndërmarrë deri në shtator për ta zbatuar këtë vendim.

Në korrik, një kandidat për kryetar të Rahovecit, tha në media sociale se Izraeli së shpejti do të “zhduket nga toka” si përgjigje ndaj incidenteve në Jerusalem. Pas kishte marrë kritika nga vendorët dhe ndërkombëtarët, nga presidenti dhe lideri i partisë së tij politike, ai nuk konkurroi për post dhe kërkoi falje.

Trafikimi i personave

Shih *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në: www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

Personat me aftësi të kufizuara

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara fizike, ndijore, intelektuale dhe mendore. Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efikase këto dispozita dhe personat me aftësi të kufizuara hasën në diskriminim.

KOSOVA

Sipas Organizatës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, HandiKos, personat me aftësi të kufizuara nuk kishin qasje të mjaftueshme në shëndetësi, ndihma sociale, rehabilitim dhe pajisje ndihmëse, dhe qasja fizike në institucione publike mbeti e vështirë edhe pas zbatimit të rregulloreve për ndërtesa dhe mbështetje administrative.

Ligji rregullon vendosjen e personave në institucione për përkujdesje psikiatrike ose shoqërore dhe i mbron të drejtat e tyre brenda institucioneve të tilla, por nuk është zbatuar. QKRMT-ja theksoi se objektet e shëndetit mendor ishin nën standarde. QKRMT-ja raportoi se disa persona me aftësi të kufizuara mendore mbaheshin në qendra të ndalimit pa kurrfarë bazë ligjore, por theksoi se gjykatat po i shqyrtonin disa raste.

Pakicat kombëtare/raciale/etnike

Pakicat etnike, përfshirë komunitetet serbe, rome, ashkallike, egjiptiane, turke, boshnjake, gorane, kroate dhe malazeze, ballafaqoheshin me shkallë të ndryshme të diskriminimit institucional dhe shoqëror në punësim, arsim, shërbime sociale, përdorim të gjuhës, liri të lëvizjes, të drejtën për t'u kthyer në shtëpi të veta (për persona të zhvendosur) dhe të drejta të tjera themelore.

Zyra e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve theksoi diskriminimin në punësim në sektorin publik pothuaj në të gjitha institucionet lokale dhe nacionale. Nuk kishte mjete ligjore për t'i trajtuar këto shqetësime. Ndonëse ligji obligon që 10 për qind e nëpunësve në nivelin lokal dhe nacional të qeverisë të jenë anëtarë të pakicave, përfaqësimi i tyre mbeti i kufizuar dhe në përgjithësi ishte i kufizuar në pozita të nivelit të ulët. Komunitetet më të vogla, si goranët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, ishin të nën-përfaqësuar.

OJQ-të raportuan për përpjekjet e universiteteve për diskriminim në pranim dhe punësim të personave që vishnin rroba fetare myslimane, përfshirë hixhabin. Ligji ndalon veshjen e simboleve fetare në shkolla fillore, por statutet kundër diskriminimit e mbrojnë veshjen fetare në nivel universitar.

Komunitetet rome, ashkallike dhe egjiptiane vuanin nga diskriminimi i përhapur shoqëror dhe ekonomik. Atyre shpesh u mungonte qasja në higjienë themelore, kujdes mjekësor dhe shkollim, dhe vareshin me të madhe nga ndihmat humanitare për mbijetesë.

Ligji kërkon kushte të barabarta për të gjithë nxënësit dhe një të drejtën për shkollim publik në gjuhën amtare për nxënësit të pakicave deri në mbarim të shkollës së mesme. Ky ligj nuk u zbatua dhe udhëheqësit boshnjakë, kroatë, goranë, malazezë, romë dhe turq theksuan se komuniteteve të tyre u mungonin librat dhe materialet e tjera shkollore.

Qasja në drejtësi për komunitetet joshqiptare, veçanërisht për serbët e Kosovës dhe personat e zhvendosur, mbeti shqetësim. Përkthimi i dobët ose mospërkthimi në procedura para gjykatave, një numër i rasteve të prapambetura, moszbatimi i vendimeve, numri i kufizuar i stafit joshqiptar, mospërputhja e përkthimeve të legjisllacionit mes gjuhës shqipe dhe serbe dhe mungesa e sistemit gjyqësor funksional në veri të Kosovës pengoi ofrimin e duhur të drejtësisë. Incidentet e sigurisë kundër serbëve të Kosovës vazhduan, veçanërisht në rajonin e Pejës, Istogut dhe Klinës. Në shtatë muajt e parë të

KOSOVA

vitit, pati mbi 105 incidente që përfshinin vjedhje, grabitje, ngacmime verbale dhe dëmtim të pronës së serbëve të Kosovës dhe të Kishës Ortodokse Serbe.

Përfaqësuesit e serbëve të Kosovës vazhdonin të kërkonin rritje të numrit të serbëve të Kosovës në forcën policore, posaçërisht në zonat e të kthyerve. Numri i serbëve të Kosovës në FSK pothuaj u dyfishua gjatë vitit, me 58 pjesëtarë të rinj.

Më 10 janar, një granatë dore shpërtheu para hotelit Sasha në Mitrovicën veriore, duke dëmtuar dritaret dhe dy automjete të parkuara. Në hoteli gjendej një numër i vogël i zyrave qeveritare që ishin pjesë e dialogut për zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit. Hetimet vazhduan.

Më 14 janar, qeveria ia mohoi hyrjen një treni të posaçëm nga Beogradi, që ishte i mbushur me deklarata nacionaliste dhe imazhe fetare serbe, ndërsa Policia e Kosovës stacionoi njësi speciale në Kosovën veriore, duke rritur kështu tensionet midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Më 15 janar, pothuajse 2.000 serbë të Kosovës u mblodhën në Mitrovicën veriore për të protestuar kundër veprimeve të qeverisë dhe policisë.

Në mbrëmjen e 14 shkurtit, një grup prej 20 shqiptarësh të rinj të Kosovës këndonin parulla anti-serbe dhe ngjyrosën grafitë anti-serbë në një zonë të banuar me serbë në Gjilan, përfshirë Kishën Ortodokse Serbe dhe muret e jashtme të një shkolle serbe. Grafiti përfshinte “Vritni serbët”, një simbol të kryqit të thyer dhe “UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës”. Grafitë anti-serbë u panë gjithashtu në një fshat të përzier etnikisht në komunën e Novobërdës. Policia e Kosovës arrestoi një të mitur shqiptar të Kosovës.

Më 29 maj, sulmues të panjohur shtinë një breshëri plumbash në një ndërtesë në të cilën ndodhen zyrat e PKS-së në komunën veriore të Leposaviqit. Nuk u raportua për të lënduar, por plumbat dëmtuan dritaret dhe një mur. Në korrik, dy politikanë të opozitës serbe të Kosovës ishin viktimë të djegies së veturës në Mitrovicën veriore. Nuk u raportua për të lënduar dhe hetimet ishin duke u zhvilluar.

Komisionari për gjuhë monitoronte dhe raportonte mbi zbatimin e legjislacionit që u jepte status të barabartë dy gjuhëve zyrtare të vendit, shqipes dhe serbishtes, si dhe gjuhëve zyrtare që përdorshin në nivel lokal, përfshirë gjuhën boshnjake, rome dhe turke. Në shkurt, komisionari u tha mediave se administratat lokale komunale nuk e respektuan në tërësi ligjin mbi përdorimin e gjuhëve, duke cekur mungesën e vullnetit politik. Ai gjithashtu theksoi mungesën e përkthimeve në gjuhën serbe, brenda disa institucioneve, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë dhe korporatën energjetike.

Ndryshimet e bëra në vendime administrative u lejojnë boshnjakëve, romëve dhe turqve të kenë dokumente identiteti të lëshuara në gjuhën e tyre, por përfaqësues të pakicave shpesh ankoheshin për zbatim të dobët.

Aktet e dhunës, diskriminimi dhe abuzimet e tjera të bazuara në orientim seksual dhe identitet gjinor

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të bazuar në orientim seksual dhe identitet gjinor në punësim, kujdes shëndetësor dhe shkollim. Kur

KOSOVA

motivimi për krim është i bazuar në gjini, orientim seksual apo lidhje të perceptuar të viktimës me personat që janë objekt i armiqësisë së tillë, ligji e konsideron atë motiv si rrethanë rënduese.

Sipas OJQ-ve për të drejta të njeriut, komuniteti LHBTI përballej me diskriminim të hapur në punësim, strehim, përcaktim të pashtetësisë, qasje në shkollim dhe kujdes shëndetësor. OJQ-të thanë se trysnia shoqërore i bindi shumicën e personave LHBTI ta fshehin orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor. OJQ-të theksuan që policia nuk ishte e ndjeshme ndaj nevojave të komunitetit të tyre.

Më 15 shkurt, një prokuror ngriti aktakuzë kundër një të pandehuri të akuzuar për sulm ndaj një personi LHBTI në bazë të preferencës seksuale në korrik të vitit 2016. Sipas OJQ-ve, deri në shtator personat LHBTI nuk raportuan asnjë krim të urrejtjes gjatë vitit, megjithëse ata theksuan se raportimi dekurajohej nga frika e hakmarrjes.

Një Grup Këshillëdhënës dhe Koordinues, i përbërë nga përfaqësues të tetë ministrive, Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe tri OJQ-ve, bashkëpunoi për t'i mbrojtur dhe promovuar të drejtat e komunitetit LHBTI, përfshirë hartimin e një plani kombëtar të veprimit. Zyrtarët e qeverisë sinjalizuan mbështetjen për të drejtat e LHBTI-ve duke sponsorizuar dhe marrë pjesë në ngjarje të shumta publike.

Turpi shoqëror për HIV dhe AIDS

Ndonëse nuk pati raportime të konfirmuara për diskriminim zyrtar ndaj personave me HIV/AIDS gjatë vitit, pati raportime anekdotike për diskriminim të tillë.

Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve

a. Liria e asociimit dhe e drejta për të negociuar kolektivisht

Ligji parashikon të drejtën e punëtorëve për të formuar dhe t'iu bashkuar sindikatave të pavarura, për të negociuar kolektivisht dhe për të bërë grevë. Ligji ndalon diskriminimin antisindikal dhe shkeljen e të drejtave të punëtorit për shkak të aktiviteteve të tij sindikale. Ligji siguron rikthimin e punëtorëve të larguar për shkak të veprimtarisë sindikale, përfshirë për shërbime themelore. Ligji zbatohet njëjloj për të gjithë individët që punojnë në sektorin publik dhe privat, përfshirë migrantët e dokumentuar dhe punëtorët vendorë.

Autoritetet nuk e zbatuan në mënyrë efektive ligjin e punës, i cili përfshin rregullore dhe udhëzime administrative që i rregullojnë marrëdhëniet e punësimit, përfshirë të drejtën e asociimit dhe negociimit kolektiv. Sipas Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), burimet, inspektimet dhe masat mbrojtëse nuk ishin adekuate dhe gjobat nuk mjaftonin. Deri në korrik, Inspektorati i Punës i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale shqiptoi 170 gjoba. BSPK tha se këto gjoba nuk mjaftonin për t'i parandaluar shkeljet. Procedurat administrative dhe gjyqësore ishin të ngatërruara dhe u nënshtroheshin vonesave të gjata apo ankesave.

KOSOVA

Sipas BSPK-së, Qeveria dhe punëdhënësit në vend në përgjithësi e respektuan të drejtën për të formuar dhe për t'iu bashkuar sindikatave në sektorin publik dhe privat. Problem mbeti ndërhyrja e partive politike në organizata sindikale dhe në të drejtat e punëtorëve individualë. Sipas zyrtarëve të sindikatës, punëtorët në sektorin publik zakonisht përballëshin me keqtrajtim, përfshirë ngacmimin seksual dhe humbjen e vendit të punës, për shkak të lidhjes së tyre me parti politike. Punëdhënësit nuk i respektonin gjithmonë të drejtat e organizatave të punëtorëve për të negociuar kolektivisht, posaçërisht në sektorin privat. BSPK raportoi se shumë punëdhënës të sektorit privat në përgjithësi i shpërfillën ligjet e punës. BSPK-ja raportoi për vështirësi të vazhdueshme në formimin e sindikatave për shkak të ndërhyrjes së punëdhënësve në shoqatat dhe sindikatat e punëtorëve, posaçërisht në sektorin bankar, të ndërtimitarisë dhe hotelier. Përfaqësues të këtyre sektorëve i thanë BSPK-së në kushte anonimiteti se punëdhënësit përdorën kërcënimin për ta penguar formimin e sindikatave. Inspektorati i Punës raportoi se nuk kishte marrë asnjë ankesë zyrtare për diskriminim ndaj punëtorëve që u përpoqën t'u bashkohen sindikatave gjatë vitit. BSPK-ja pohoi që Inspektorati nuk ishte plotësisht funksional për shkak të mungesës së buxhetit dhe të stafit.

b. Ndalimi i punës së dhunshme apo të detyruar

Ligji i ndalon të gjitha format e punës së dhunshme apo të detyruar, por puna e dhunshme e fëmijës ndodhi gjatë vitit (shih Seksionin 7.c.).

Burimet e Qeverisë, përfshirë masat mbrojtëse, nuk ishin të mjaftueshme për të siguruar zbatim të ligjit, për t'i identifikuar dhe mbrojtur viktimat, dhe për t'i hetuar pohimet për punë të dhunshme apo të detyruar. Pati hetime, ndjekje penale apo dënime të kufizuara për punë të dhunshme për shkak të, sipas Inspektoratit të Punës, burimeve joadekuate. Dënimet sillëshin prej dënimit me burgim dhe gjoba deri në 500.000 euro (600.000 dollarë) dhe ishin mjaft të rrepta në krahasim me dënimet për krime të tjera të rënda. Deri në tetor, autoritetet nuk larguan asnjë viktimë nga puna e dhunshme.

Shih gjithashtu *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në: www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

c. Ndalimi i punës së fëmijës dhe mosha minimale për punë

Mosha minimale për punë është 15 vjet, nëse puna e tillë nuk është e dëmshme për fëmijën apo nuk e pengon atë për ta vijuar mësimin. Nëse puna ka të ngjarë ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve, mosha minimale ligjore është 18 vjet. Në vitin 2013, qeveria u pajtua me Organizatën Ndërkombëtare të Punës për mbrojtjen e fëmijëve nga puna e rrezikshme në bujqësi, rrugë, ndërtimtari dhe eksploatim të resurseve natyrore. Rregulloret ndalojnë shfrytëzimin e fëmijëve në vend të punës, përfshirë punën e dhunshme apo të detyruar. Qeveria e mbështeti një komision për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijës për të ndërhyrë në raste të punës së dhunshme apo të rrezikshme. Ky komision ishte i kufizuar për shkak të burimeve të pakta. Qeveria gjithashtu financoi Këshillin Kombëtar kundër trafikimit të personave që i hetonte rastet e trafikimit të fëmijëve për punë.

KOSOVA

Inspektorët menjëherë i njoftonin punëdhënësit kur i gjenin të miturit duke punuar në kushte të rrezikshme. Deri në maj, zyrat komunale për punë sociale (ZKPS) ia raportuan MPMS-së vetëm tetë raste të të miturve që punonin në kushte të rrezikshme; por ajo nuk kishte informata nëse fëmijët ishin kthyer në shkollë. Ministria theksoi se ZKPS shpesh i raportonte gabimisht Ministrisë për raste të të miturve që punonin në kushte të rrezikshme për shkak të një mjeti të ri të raportimit që lejonte raportim të njëkohshëm në Ministri dhe ZKPS.

OJQ-të raportuan se buxhetet e MPMS-së nuk mjaftonin për t'u ofruar shërbime sociale fëmijëve të përfshirë në punën në rrugë. ZKPS vazhdoi të kërkonte mbështetje buxhetore për qendrat në objekte për t'u ofruar shërbime ditore sociale fëmijëve të përfshirë në punën e paligjshme.

Sipas Ligjit të punës, inspektorët mund t'i gjobisin punëdhënësit prej 100 euro (120 dollarë) deri në 10.000 euro (12.000 dollarë) për shkak të detyrimit të një punëtori për të punuar në kushte të rrezikshme të punës. Gjobat ishin të dyfishta për veprat penale të kryera kundër një të mituri. Zbatimi ishte i dobët për shkak të trajnimit joadekuat dhe burimeve të pamjaftueshme. Ligji parashikon ndëshkime shtesë për punëdhënësit dhe familjet që i angazhojnë fëmijët në praktika të punës ose që dështojnë t'i përmbushin detyrimet e tyre prindërore duke rezultuar në punësim të paligjshëm të të miturit. Ligji u lejon autoriteteve ta largojnë një fëmijë nga shtëpia nëse përcaktohet që kjo është në interesin më të mirë të fëmijës.

Koalicioni për Mbrojtjen e Fëmijëve (KMF) raportoi se fëmijët që punojnë në bujqësi dhe në sektorin e minierave hasnin në rreziqe që lidheshin me përdorimin e pajisjeve bujqësore dhe nxjerrjen e mineraleve nga vendet në të cilat arrihej me vështirësi. KMF raportoi se angazhimi i fëmijëve në bujqësi vazhdoi si aktivitet tradicional. Qendrat për punë sociale të drejtuara nga qeveria raportuan se fëmijët e angazhuar në aktivitete bujqësore nuk pengoheshin nga vijimi i mësimin në shkollë. KMF gjithashtu raportoi se nuk dihej numri i përgjithshëm i fëmijëve lypsarë. Ndonëse fëmijët rrallëherë ishin siguresit kryesorë të të ardhurave për familjet e tyre, puna e fëmijës shërbeu si kontribut i madh në të ardhurat e disa familjeve.

Fëmijët e rinj në zonat rurale shpesh u ndihmonin familjeve të veta në punë bujqësore, madje edhe gjatë orarit të mësimin. Fëmijët e qytetit shpesh punonin në një sërë punësh joformale në ndërtimtari dhe të shitjes me pakicë, si shitja e gazetave, cigareve, ushqimit dhe kartelave të telefonit në rrugë. Disa fëmijë gjithashtu merreshin me punë fizike, si transportimi i mallrave.

Shih Konkluzionet mbi format më të këqija të punës së fëmijës të Departamentit të Punës në: www.dol.gov/ilab/reports/child-labor/findings/.

d. Diskriminimi në lidhje me punësimin ose profesionin

Diskriminimi në punësim dhe profesion ndodhi në të gjithë sektorët në lidhje me seksin, gjininë, identitetin gjinor, aftësinë e kufizuar dhe statusin minoritar (shih Seksionin 6). Gjatë vitit, BSPK-ja pranoi raporte prej sindikatave të punës dhe individëve që pohonin për diskriminim në bazë të anëtarësisë, moshës dhe gjendjes familjare. BSPK-ja pohoi se

KOSOVA

ishte i vetmi subjekt ku punëtorët e raportonin diskriminimin për shkak të frikës nga hakmarrja e punëdhënësit. BSPK-ja vuri në pah se punësimi varej pothuaj ekskluzivisht nga statusi dhe lidhja politike e punëtorit. BSPK-ja gjithashtu theksoi se për shkak të papunësisë së lartë, punëtorët ngurronin ta raportonin diskriminimin, duke iu frikësuar hakmarrjes nga punëdhënësi i tyre. Punëtorët më së shpeshti i trajtonin çështjet e tyre të punës brenda dhe jozyrtarisht me punëdhënësit e tyre. BSPK-ja gjithashtu raportoi raste kur punëdhënësit i diskriminuan kandidatët femra gjatë intervistave për punësim dhe i përjashtonin në mënyrë të paligjshme femrat për shkak të shtatzënisë ose për shkak se kërkonin pushim të lehonisë.

Vëzhguesit ndërkombëtarë raportuan për diskriminim në punësimin universitar ndaj individëve të veshur me hixhab ose simbole të tjera islame. Universitetet nganjëherë i refuzonin kandidatët mbi këtë bazë, duke justifikuar praktikën si përpjekje kundër radikalizmit.

Ligji nuk mbron nga diskriminimi në bazë të statusit HIV ose sëmundjeve të tjera të transmetueshme. Sipas OJQ-së Instituti GAP, dënimet ishin adekuate, por zbatimi ishte i pamjaftueshëm në mënyrë që sistemi të funksiononte siç duhet.

Sipas ligjit, të huajt duhet të marrin leje pune para se të kërkojnë të punojnë në vend. Sipas Inspektoratit të Punës, nuk pati raportime që punëtorëve të huaj u ishin mohuar lejet e punës dhe nuk pati raportime që të drejtat e punëtorëve të huaj ishin shkelur gjatë vitit.

e. Kushtet e pranueshme të punës

Rroga minimale e caktuar nga qeveria ishte më e lartë se linja zyrtare e të ardhurave të varfërisë prej 1.82 euro (2.18 dollarë) në ditë. Ligji siguron përfitime mujore deri në 120 euro (144 dollarë) për familjet që kanë të drejtë për asistencë sociale dhe deri në 40 euro (48 dollarë) për individë. Familjet dhe individët mund të kenë zbritje deri në 400 kW/h energji elektrike dhe kujdes shëndetësor falas.

Ligji parashikon javën standarde të punës prej 40 orësh, kërkon periudha pushimi, kufizon numrin e orëve të rregullta të punës deri në 12 orë në ditë, kufizon punën jashtë orarit deri në 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj, kërkon pagesën shtesë për punën jashtë orarit dhe ndalon punën e tepërt e të detyrueshme jashtë orarit. Ligji parashikon 20 ditë pushim me pagesë në vit për punëtorë dhe 12 muaj pushim pjesërisht të paguar të lehonisë. Ligji i punës i përcakton standardet e shëndetit dhe të sigurisë për vende të punës dhe qeveris me të gjitha industritë në vend.

Inspektorët e punës ishin përgjegjës për zbatimin e të gjitha standardeve të punës, përfshirë ato që kanë të bëjnë me rrogat, orarin e punës, sigurinë dhe shëndetin. Sindikatat dhe inspektorët e punës konsideronin që gjambat dhe numri i inspektorëve ishte i pamjaftueshëm për ta monitoruar me efikasitet sektorin formal dhe joformal.

Sipas Inspektoratit të Punës dhe BSPK-së, ligji i punës është gjithëpërfshirës dhe dispozitat e tij për orarin e punës janë adekuate për mbrojtje të barabartë të punëtorëve në sektorin publik dhe privat. Sipas BSPK-së, mungesa e zbatimit të ligjit nga qeveria ishte

KOSOVA

rrjedhojë e numrit të paktë të punëtorëve të sindikatës, si dhe e kufizimeve në burime dhe kapacitete të Inspektoratit të Punës.

Ministria e Punës vazhdoi përpjekjet për hartimin e ndryshimeve në Ligjin e punës, të nevojshme për ta zbatuar kontratën kolektive, të sponsorizuar nga qeveria. Kontrata kolektive i përcakton të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëtorit, përfshirë dispozitat mbi orët e punës, punën e natës, pushimin vjetor, pushimin e lehonisë, sigurinë në punë dhe beneficionet shëndetësore të punëtorit. Kontrata gjithashtu përfshin të gjitha mbrojtjet e parapara në ligje të punës dhe vlen për të gjithë punëtorët në ekonominë joformale dhe formale. Vëzhguesit vunë në pah se marrëveshja kishte për qëllim zvogëlimin e madhësisë së ekonomisë joformale, të cilën qeveria dhe organizatat ndërkombëtare e vlerësuan në 30 për qind të ekonomisë së përgjithshme, duke i ndëshkuar punëdhënësit që nuk i regjistrojnë punëtorët.

Sipas BSPK-së, punëdhënësit dështonin t'i respektonin standardet zyrtare të punës të cilat siguronin standarde të barabarta të mbrojtjes për punëtorët e sektorit publik dhe privat. BSPK-ja raportoi për mungesë të mbikëqyrjes qeveritare dhe të zbatimit të ligjit, posaçërisht lidhur me javën standarde të punës dhe punën e detyrueshme e të papaguar jashtë orarit. Shumë individë punonin me orar të gjatë në sektorin privat, kinse sipas dëshirës së tyre, pa kontratë pune, pagesë të rregullt apo kontribute pensionale. BSPK-ja raportoi se punëdhënësit i shpërfillnin dispozitat ligjore dhe i përjashtonin punëtorët pa arsye në kundërshtim me ligjin dhe refuzonin t'i respektonin festat e punëtorëve. Deri në shtator, Inspektorati i Punës pranoi 204 ankesa zyrtare për shkelje të të drejtave të punëtorëve në sektorin publik dhe privat. Organizata për të drejtat e gruas raportuan se abuzimi dhe ngacmimi seksual ndodhte në vend të punës, por kalonte pa u raportuar për shkak të frikës për përjashtim nga puna apo hakmarrja.

Ndonëse ligji parashikon mbrojtje të shëndetit të punëtorëve dhe kushte të punës, institucionet private dhe publike nuk e respektonin atë nganjëherë. Zyrtarët e Inspektoratit të Punës dhe të BSPK-së raportuan për vështirësi në marrjen e informatave të sakta për zbatim të ligjit, sepse punëtorët rrallë i zbulonin problemet për shkak të frikës për humbje të vendit të punës. Deri në tetor, Inspektorati i Punës raportoi për 10 fatalitete në vend të punës.

Asnjë ligj në veçanti nuk i lejon punëtorit ta lërë punën për shkak të një situatë të rrezikshme të punës, por ligji kërkon që çdo punëdhënës t'u sigurojë të gjithë punëtorëve kushte adekuate të punës duke u bazuar në kërkesat e punës. Sipas Ministrisë së Punës, marrëveshjet joformale punëdhënës-punëtor mund ta trajtojnë çështjen kur dhe nëse një punëtor mund ta lërë punën për shkak të situatave të rrezikshme të punës. Institucionet e vendit nuk i kanë shqyrtuar këto marrëveshje. Sipas ekspertëve, shkeljet e standardit të rrogës, të punës jashtë orarit, të shëndetit dhe sigurisë në punë ishin njëloj për meshkuj dhe femra, si dhe për punëtorët e huaj migrantë, posaçërisht për ata që ballafaqoheshin me kushte të rrezikshme apo eksploatuese të punës.